

Plani i punës për shërbimet që do të ofrohen nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën Janar – Dhjetor 2018

Për Programin e riintegrit të personave të riatdhesuar nga vendet e BE-së, ZKKK planifikon të realizojë këto plane:

- Planifikohen të mbahen edhe 10 takime të rregullta të Komisionit Komunal për Riintegrim
- Planifikohet aprovimi i 30 kërkesave për akomodim (banim me qera); 35 Kërkesa për pako të dimërit (dru zjarri); 15 Kërkesa për medikamente dhe trajtim mjeksorë; 10 Kërkesa për orëndi shtëpiake; 5 Kërkesa për renovim/rindertim të shtëpisë;
- Përafërsisht planifikohet të riatdhesohen nga vendet e BE-së rreth 200 - 300 persona;

Për programin e personave të zhvendosur nga Mali i Zi dhe Brenda për Brenda vendit planifikohen këto aktivitete:

Për programin e kthimit të personave të zhvendosur në Mal të Zi, ZKKK planifikon të realizoj këto aktivitete si në vijim:

- Me IOM planifikohet ndërtimi i 7+7 shtëpijave për të zhvendosurit e Malit të Zi, me mjetet e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete;
- Me DRC, planifikohen të ndërtohen 5 shtëpi, me fonde të Ambasades Britaneze për personat e zhvendosur Brenda vendit;
- Planifikohen të mbahen 2 -3 vizita shko dhe informo në kampet e Malit të Zi si dhe 1-2 vizita shko dhe shiqo;
- Përafërsisht planifikohet të kthehen nga kampet e Malit të Zi deri në 14 familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian nga kampet e Malit të Zi;
- Pranimi i kërkesave të tyre dhe interesimi i tyre për kthim;
- Asistenca për ndërtim të shtëpisë dhe asistencat e tjera;
- Në rast të pranimit të kërkesave për kthim zyra ndihmon në rregullimin e dokumentave për nxjerrjen e lejes komunale për ndërtim si dhe procedurat tjera;
- Regjistrimi i të kthyerve në Komunën e Gjakovës etj.

Projektet për zhvillim të komuniteteve dhe integrim, ZKKK planifikon të realizoj këto aktivitete si në vijim:

- Pranimi i projekteve nga ana e OJQ-ve që kanë të bëjnë me zhvillimin e komuniteteve; pranimi i kërkesave urgjente për raste të veqanta, si dhe pranimi i kërkesave për pagesë të qirasë nga ana e ZKKK-së;
- Subvencionimi i 15 kërkesave për pagesë të qirasë;
- Subvencionimi i OJQ-ve lokale dhe qendrave të komuniteteve për funksionalizimin e tyre dhe zhvillimin e projekteve për arsim, kulturë, rini dhe media;

Projektet për plane të bizneseve dhe gjenerim dhe projekte zhvillimore të të ardhurave në koordinim me donatorët:

- Pritet vazhdimi i projektit për stabilizim të komuniteteve ku planifikojmë që ti mbështesim edhe 5 biznese të komuniteteve në profile të ndryshme;

Aktivitete tjera të Zyrës për komunitete dhe kthim janë:

- Planifikojmë mbajtjen dhe organizimin e disa takimeve me komunitetet nëpër lagje dhe fshatra lidhur me nevojat e tyre;
- Organizimi i debateve, tryezave të rrumbullakëta lidhur me të drejtat e komuniteteve, edukimin, punësimin si dhe mirëqenjen sociale;
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të komuniteteve;